

**Z. Helidon Bushati** është zgjedhur anëtar i Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës me Vendimin nr.6, datë 25.1.2018 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Z. Bushati është diplomuar për “Marrëdhënie Ndërkombëtare” në Universitetin e Padovas, Itali. Ai ka realizuar studimet master “Për karrierë diplomatike dhe funksionet ndërkombëtare” (2002), po pranë këtij universiteti.

Në karrierën e tij profesionale, ai ka një përvojë të pasur drejtuese në institucione të ndryshme publike të administratës shtetërore.

Z. Bushati ka qenë Drejtor i Përgjithshëm i Spitalit Universitar “Nënë Tereza”, Tiranë (2013).

Në periudhën 2010 - 2013 ka punuar si Drejtor i Përgjithshëm i Burimeve dhe Modernizim, Ministria e Mbrojtjes, dhe në periudhën nga 2007- 2010 ka kryer detyrën e Drejtorit të Administrimit të Pronës Publike, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.

Z. Bushati, në periudhën 2005-2009, ka qenë i zgjedhur deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Z. Bushati, ka një aktivitet edhe në fushën e mësimdhënies, ku gjatë periudhës 2007-2009, ai është aktivizuar si pedagog i jashtëm pranë Fakultetit të Shkencave Politike, Universiteti “Zoja e Këshillit të Mirë”, dhe në periudhën 2003-2006, pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

Z. Bushati ka qenë përfaqësues dhe speaker i Shqipërisë në shumë aktivitete ndërkombëtare me tematikë ekonomike, si brenda ashtu dhe jashtë vendit.